



Pivot

Moduli 1

**Bashkimi European
Roli dhe institucionet**



Co-funded by
the European Union

Pivot

Moduli 1


Bashkimi European Roli dhe Institucionet



Co-funded by
the European Union

Tabela e Përmbajtjes

Hyrja	4
Pyetësor vetëvlerësimi fillestar	5
Kapitulli 1: Bashkimi Europian: Themelimi, institucionet dhe vlerat	6
1.1 Rrjedha Historike	6
1.2 Shtetet anëtare	10
1.3 Institucionet e Bashkimit Europian	11
1.4 Vlerat dhe parimet e Bashkimit Europian	12
1.5 Prioritetet e Bashkimit Europian	14
1.6 Plani i veprimit dhe axhenda strategjike për BE	15
1.7 Veprimet dhe të drejtat e Bashkimit Europian në lidhje me : barazinë gjinore, ndryshimet klimatike, diskriminimin	18
Kapitulli 2: Të jetosh në Bashkimin Europian	20
2.1 Të jetosh në BE	20
2.2 Të udhëtosh në BE	21
2.3 Të punosh në Bashkimin Europian	22
2.4 Emigracioni në BE	22
2.5 Të studiosh, trajnimet dhe vullnetarizmi në Bashkimin Europian	23
Kapitulli 3: Qytetaria në Bashkimin Europian	24
3.1 Zgjedhjet Europiane dhe e drejta e votës	24
3.2 Iniciativa e Qytetarëve Europianë	25
3.3 Peticion ndaj Bashkimit Europian	25
3.4 Këshilli Vendor	26
Aktivitete	27
Aktiviteti 1: Simulimi Parlamentit Europian	27
Aktiviteti 2: Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian	29
Pyetësori vetëvlerësimi përfundimtar	30
Referenca	31





Hyrje

Objektivi i përgjithshëm i projektit Pivot –“Të rinjtë promovojnë votimin e informuar” është të nxisë qytetarinë gjithëpërfshirëse dhe aktive të të rinjve, duke i përgatitur ata për zgjedhjet e ardhshme të vitit 2024 dhe më tej. Megjithëse zgjedhjet europiane të vitit 2019 patën pjesëmarrjen më të lartë politike të parë ndonjëherë (duke u rritur nga 42.6% në 2014 në 50.6% në 2019), tendenca e përgjithshme që nga viti 1979 ka qenë në rënie të vazhdueshme dhe në disa vende, pjesëmarrja ishte shumë e ulët me pothuajse me paraqitjen e vetëm një të tretën e qytetarëve për të dhënë votën e tyre. Për këtë arsye, zgjedhjet e ardhshme parlamentare të BE-së në vitin 2024 do të jenë një moment i rëndësishëm për të vlerësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve europianë në Bashkimin Europian. Vitet e fundit, Bashkimi Europian ka përjetuar një valë lëvizjesh populiste që mbrojnë autonomi më të mëdha kombëtare. Edhe pse shumica e qytetarëve të vendeve anëtare janë në favor të BE-së, ky zhvillim ka shkaktuar rritje të ekstremizmit, polarizimit politik dhe manifestimeve të një ndjenje anti-europiane. Objektivi i përgjithshëm i PIVOT është të rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve të BE-së në zgjedhjet Parlamentare të BE-së dhe të rrisë interesin e përgjithshëm të qytetarëve tek politikën e BE-së përmes zbatimit të një sërë seminaresh, webinarësh dhe publikimesh tematike. Nëpërmjet aktiviteteve të tij, PIVOT do t'i afrojë qytetarët më pranë institucioneve të BE-së, duke rritur njohuritë e tyre për mundësitë dhe politikën e BE-së dhe duke i bërë qytetarët përgjegjës për pjesëmarrjen e tyre aktive në jetën politike demokratike europiane.

Pyetësor vetëvlerësues fillestar

Le të vlerësojmë dijen tënde

mbi Bashkimin European

Në fillim të modulit, ti mund të testosh dijen tënde mbi temën duke vlerësuar veten. Ju lutem, plotësoni pyetësin e mëposhtëm. Në fund do të merrni një email me pikët tuaja.

Përpiquni të krahasoni pikët me pyetësin e dytë në fund të modulit :

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSeshA5TgG_0i8S_eeikjNAVv0_1q6I3cbPLRz9W3FIJlvz5Sw/viewform



Kapitulli 1

Bashkimi European: Themelet, institucionet dhe vlerat

1.1 Rrjedha Historike

1950

9 maj 1950 - Një Europë e Paqes - fillimet e bashkëpunimit

9 maji 1950 shënon një moment të rëndësishëm në histori kur Robert Schuman, në atë kohë Ministri i Jashtëm i Francës, deklaroi në fjalimin e tij: “Paqja botërore nuk mund të ruhet pa bërë përpjekje të reja që janë në përpjesëtim me rreziqet që e kërcënojnë atë”. Këto fjalë nuk u injoruan. Më 18 prill 1951, ambicia e Schuman-it u kthye në realitet dhe Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut (ECSC) u krijua zyrtarisht me nënshkrimin e Traktatit të Parisit. Gjashtë vende europiane - Franca, Gjermania Perëndimore, Italia, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu - nënshkruan traktatin themelues të Komunitetit European të Qymyrit dhe Çelikut (ECSC). ECSC hyri në fuqi në 1952, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt bashkëpunimit european.

1957-1958

25 mars 1957 – Traktatet e Romës

Duke pasur parasysh suksesin e Traktatit të Qymyrit dhe Çelikut, gjashtë vendet themeluese vendosën të shtrijnë bashkëpunimin e tyre në sektorë të tjerë ekonomikë. Ky angazhim u zyrtarizua me nënshkrimin e dy traktateve, duke krijuar Komunitetin Ekonomik Europian (EEC) dhe Komunitetin Europian të Energjisë Atomike (Euratom). Të dyja organizatat hynë në veprim më 1 janar 1958, duke shënuar një tjetër hap përpara në ndërtimin e bashkësisë europiane.

19 mars 1958 – Lindja e Parlamentit Europian

Takimi i parë i Asamblesë Parlamentare Europiane, pararendës i Parlamentit Europian të sotëm, u zhvillua në Strasburg të Francës, me Presidentin e zgjedhur Robert Schuman. Asambleja Parlamentare Europiane zëvendësoi Asamblenë e Përbashkët të Komunitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut dhe, më 30 mars 1962, u bë i njohur si Parlamenti Europian.

1973-1979

1 Janar, 1973 – Nga 6 në 9 Shtete Anëtare

Me pranimin zyrtar të Danimarkës, Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar, vendet anëtare të Komuniteteve Europiane u rritën në nëntë.

Qershor 1979 – Zgjedhjet e para të drejtpërdrejta për Parlamentin Europian

Për herë të parë, qytetarët europianë patën mundësinë të zgjedhin drejtpërdrejt anëtarët e Parlamentit Europian. Më parë, eurodeputetët emëroheshin përmes nominimeve nga parlamentet kombëtare. Me këtë sistem të ri, eurodeputetët u organizuan në grupe politike pan-europiane dhe jo në delegacione kombëtare, duke bërë një hap të rëndësishëm drejt një përfaqësimi më të drejtpërdrejtë dhe më të integruar të Bashkimit Europian.

1986–1987

Programi Erasmus

Pavarësisht heqjes së detyrimeve doganore në vitin 1968, tregtia midis vendeve anëtare vazhdoi të pengohej nga ndryshimet në normat kombëtare. Për të adresuar këtë çështje, Akti Unik European propozoi një program gjithëpërfshirës gjashtëvjeçar që synon tejkalimin e këtyre pengesave dhe krijimin e një tregu të vetëm. Ai hyri në fuqi më 1 korrik 1987.

13 qershori 1987 shënon fillimin e programit Erasmus, i projektuar për të siguruar fonde për studentët e universitetit të interesuar për të studiuar në një vend tjetër european. Që nga nisja e tutje, programi pati një ndikim të rëndësishëm, duke u ofruar mbi 10 milionë njerëzve mundësinë për të studiuar, trajnuar, vullnetarizuar ose për të fituar përvojë pune jashtë vendit.

1989–1992

Traktati i Mاستrihtit

Në fillim të viteve '90, Lufta e Ftohtë mund të konsiderohej e përfunduar: Muri i Berlinit ra në 1989, Gjermania u ribashkua në 1990 dhe Bashkimi Sovjetik u shemb në 1991.

Pas ndryshimeve rrënjësore në peizazhin politik european, vendet e Komunitetit Ekonomik European ndjenë nevojën për të ripërcaktuar strukturën e kontinentit. Me Traktatin e Mاستrihtit, të nënshkruar nga përfaqësuesit e vendeve anëtare (atëherë 12) në shkurt 1992, u krijua zyrtarisht Bashkimi European (BE).

1999–2022

Euro

Euro u prezantua më 1 janar 1999 dhe u bë monedhë për mbi 300 milionë qytetarë europianë. Vendet e para që miratuan euron ishin Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Gjermania, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia dhe Spanja.

Më pas, kartëmonedhat dhe monedhat euro u bënë kursi ligjor i 12 vendeve të BE-së (Greqia u bashkua me zonën e euros në 2001 dhe vendet e tjera pasuan pas 2002).

2007–2023

Traktati i Lisbonës

Në vitin 2007, Bashkimi European kishte 27 vende anëtare, të cilat nënshkruan Traktatin e Lisbonës, duke bërë ndryshime në traktatet e mëparshme. Qëllimi kryesor i traktatit ishte ta bënte BE-në më demokratike, efikase dhe transparente për të adresuar sfidat globale si ndryshimet klimatike, siguria dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Para hyrjes së tij në fuqi më 1 Dhjetor 2009, të gjitha vendet e BE-së e ratifikuan traktatin. Sot, BE-ja është një bashkim ekonomik dhe politik, unik në llojin e tij, i përbërë nga 27 vende anëtare që përfshinë një pjesë të madhe të kontinentit European.

1.2 Shtetet anëtare

Në vitin 1957, Belgjika, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda dhe Gjermania Perëndimore nënshkruan Traktatin e Romës, i cili krijoi Komunitetin Ekonomik Europian (EEC) dhe themeloi një bashkim doganor. Ata gjithashtu nënshkruan një pakt tjetër për krijimin e Komunitetit Europian të Energjisë Atomike (Euratom) për bashkëpunim në zhvillimin e energjisë bërthamore.

- 1973** Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar i bashkohen Bashkimit Europian, duke e çuar numrin e shteteve anëtare në nëntë.
- 1981** Greqia hyn në BE, e cila ka qenë e pranueshme për t'u anëtarësuar që kur regjimi i saj ushtarak u përmbys dhe demokracia u rivendos në 1974.
- 1986** Spanja dhe Portugalia u bën anëtare.
- 1995** Austria, Finlanda dhe Suedia i bashkohen BE-së. 15 anëtarët tani mbulojnë pothuajse të gjithë Europën Perëndimore.
- 2004** Republika Çeke, Estonia, Qipro, Letonia, Lituania, Hungaria, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia i bashkohen BE-së.
- 2007** Rumania dhe Bullgaria i bashkohen BE-së, duke e çuar numrin e vendeve anëtare në 27 vende.
- 2013** Kroacia hyn në BE.

1.3 Institucionet e Bashkimit European

Kuadri institucional i Bashkimit European është unik dhe sistemi i tij vendimmarrës po përmirësohet vazhdimisht. 7 institucione europiane, 7 organe të BE-së dhe mbi 30 agjenci të decentralizuara janë të shpërndara në të gjithë BE-në. Ata të gjithë punojnë së bashku për të mbrojtur interesat e përbashkëta të BE-së dhe qytetarëve europianë.

Ka katër institucione kryesore vendimmarrëse që drejtojnë administratën e BE-së dhe ofrojnë kolektivisht udhëzime politike, duke luajtur role të ndryshme në procesin legjislativ:



Parlamenti European

(Bruksel / Strasburg / Luksemburg) (PE) përbëhet nga 751 anëtarë të Parlamentit European të zgjedhur në 27 Shtetet Anëtare të Bashkimit të zgjeruar European. Që nga viti 1979, eurodeputetët janë zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë universal për një mandat pesë-vjeçar. Me Traktatin e Lisbonës, fuqitë e Parlamentit European janë forcuar.



Këshilli European

(Bruksel) mbledh së bashku krerët e shteteve ose qeverive të çdo vendi të BE-së dhe vendos për drejtimin politik të BE-së. Këshilli i Bashkimit European (Bruksel/Luksemburg) përbëhet nga një ministër nga çdo Shtet Anëtar dhe është pjesë e procesit legjislativ në BE.



Komisioni European

(Bruksel/Luksemburg/Përfaqësitë në mbarë BE-në) është dega ekzekutive e Bashkimit European. Ky dokument ilustron kuptimin, rolin dhe funksionet e Komisionit European dhe funksionimin e tij brenda BE-së.

Puna e tyre plotësohet nga institucione dhe organe të tjera, duke përfshirë:



Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European

(Luksemburg) siguron që ligji european të interpretohet dhe zbatohet në çdo Shtet Anëtar. Zbuloni funksionet e tjera të rëndësishme të kësaj gjykate.



Banka Qëndrore Europiane

(Frankfurt) përcakton dhe zbaton politikën monetare të BE-së me qëllim ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe mbështetjen e politikave të përgjithshme ekonomike të Unionit.



Gjykata e Auditorëve

Detyra e të cilit është auditimi dhe kontrolli i llogarive dhe buxheteve të institucioneve të Bashkimit European.

1.4 Vlerat dhe parimet e Bashkimit European

Traktati për Bashkimin European – TITULLI I DISPOZITAT E PËRBASHKËTA – Neni 2:

“Bashkimi European është krijuar mbi vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave, siç parashikohen në nenin 2 të Traktatit mbi Bashkimin European (TEU). Këto vlera janë të përbashkëta për shtetet anëtare në një shoqëri të karakterizuar nga pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave. [1]

[1] Article 2 Treaty on European Union:

<https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/146/the-protection-of-article-2-teu-values-in-the-eu> and https://eur-lex.europa.eu/eli/treaty/teu_2012/art_2/oj.

Bashkimi European është themeluar mbi vlerat e mëposhtme: [2]

Dinjiteti njerëzor

Dinjiteti njerëzor është i pacenueshëm. Ai duhet respektuar, mbrojtur dhe përbën bazën e vërtetë të të drejtave themelore.

Liria

Liria e lëvizjes u jep qytetarëve të drejtën të lëvizin dhe të banojnë lirisht brenda Unionit. Liritë individuale si respektimi i jetës private, liria e mendimit, feja, tubimi, shprehja dhe informimi mbrohen nga Karta e të Drejtave Themelore të BE-së.

Demokracia

Funksionimi i BE-së bazohet në demokracinë përfaqësuese. Një qytetar european gëzon automatikisht të drejtat politike. Çdo qytetar i rritur i BE-së ka të drejtë të kandidojë dhe të votojë në zgjedhjet për Parlamentin European. Qytetarët e BE-së kanë të drejtë të kandidojnë dhe të votojnë në vendin e tyre të banimit ose në vendin e tyre të origjinës.

Barazia

Barazia ka të bëjë me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët para ligjit. Parimi i barazisë midis grave dhe burrave mbështet të gjitha politikat europiane dhe është baza për integrimin european. Zbatohet në të gjitha fushat. Parimi i pagës së barabartë për punë të barabartë u bë pjesë e Traktatit të Romës në 1957.

[2] EU Charter of Fundamental Rights https://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

Shteti i së drejtës

BE-ja bazohet në sundimin e ligjit. Çdo gjë që bën BE-ja bazohet në traktate, të miratuara vullnetarisht dhe në mënyrë demokratike nga vendet e saj të BE-së. Ligji dhe drejtësia mbështeten nga një gjyqësor i pavarur. Vendet e BE-së i dhanë juridiksionin përfundimtar Gjykatës Europiane të Drejtësisë - vendimet e saj duhet të respektohen nga të gjithë.

Të drejtat e njeriut

Të drejtat e njeriut mbrohen nga Karta e të Drejtave Themelore të BE-së. Këto mbulojnë të drejtën për të qenë të lirë nga diskriminimi bazuar në seksin, origjinën racore ose etnike, fenë ose besimin, aftësitë e kufizuara, moshën ose orientimin seksual, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale dhe të drejtën për të pasur akses në drejtësi.

1.5 Prioritetet e Bashkimit European

Këshilli European ka përkrahur katër fusha prioritare në programin e tij strategjik për 2019-2024, të cilat do të udhëheqin veprimin e institucioneve të BE-së gjatë 5 viteve të ardhshme. Këto zona janë krijuar për të adresuar sfidat e theksuara nga situata aktuale globale dhe për të kapur mundësitë. Prioritetet aktuale të BE-së përfshijnë mbrojtjen e qytetarëve dhe lirive, zhvillimin e një baze ekonomike të fortë dhe të gjallë, ndërtimin e një Europe neutrale ndaj klimës, të gjelbër, të drejtë dhe sociale, dhe promovimin e interesave dhe vlerave europiane në skenën globale.

1.6 Plani i veprimit dhe axhenda strategjike për BE-në

Prioritetet e Bashkimit Europian (BE)^[3] janë të strukturuar dhe të organizuar nëpërmjet mekanizmave specifike dhe korniza e përgjithshme përfshin:

Axhenda Strategjike

Këshilli Europian përcakton prioritetet për 5 vitet e ardhshme. Institucionet dhe vendet e BE-së punojnë së bashku për zbatimin e këtyre prioritetëve. Komisioni Europian, Parlamenti Europian dhe Këshilli nxjerrin konkluzione të përbashkëta dhe së bashku, këto prioritete përbëjnë axhendën strategjike.

Prioritetet e Komisionit Europian

Udhëzimet politike të Komisionit për 5 vitet e ardhshme, të vendosura nga kandidati për Kryesinë e Komisionit dhe të paraqitura në Parlamentin Europian. Këto udhëzime më pas shndërrohen në deklarata të misionit për çdo kandidat për komisioner dhe i paraqiten Komisionit Parlamentar përkatës.

Prioritetet e Presidencës së Këshillit të BE-së

Këto prioritete, të vendosura nga vendi që mban Presidencën, synojnë të forcojnë BE-në dhe të promovojnë vlerat e saj themelore, duke marrë parasysh çështjet urgjente për BE-në.

[3] European Union priorities 2019-2024:

https://european-union.europa.eu/priorities-and-actions/eu-priorities/how-eu-priorities-are-set/infographic-eu-priorities_en

Prioritetet e Parlamentit European

Çdo grup politik zgjedh prioritetet duke reflektuar mbi çështje që votuesit e tyre i konsiderojnë vendimtare për 5 vitet e ardhshme. Janë 7 grupe politike të organizuara nga drejtimi politik dhe jo nga kombësia, që luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces.



Si funksionon në praktikë:

Gjendja e Bashkimit dhe Letra e Qëllimeve

Çdo shtator, Presidenti i Komisionit fillon përgatitjen e programit vjetor të punës me adresimin e gjendjes së Unionit dhe Letrën e Qëllimeve bazuar në Raportin Strategjik të Parashikimit të Komisionit.

Diskutimet

Komisioni angazhohet në diskutime me Parlamentin Europian dhe Këshillin e BE-së për prioritetet për vitin e ardhshëm.

Programi Vjetor i Punës i KE-së

Komisioni mbledh opinione nga Komiteti i Rajoneve dhe Komiteti Ekonomik dhe Social Europian për t'i integruar ato në programin e tij vjetor të punës.

Deklaratë e Përbashkët Vjetore

Komisioni, Parlamenti dhe Këshilli nxjerrin një deklaratë të përbashkët mbi prioritetet e BE-së për të siguruar veprim të shpejtë dhe fuqi politike për arritjen e këtyre prioriteteve.

[4]

[4] European Union priorities 2019-2024:
https://european-union.europa.eu/priorities-and-actions/eu-priorities/how-eu-priorities-are-set/infographic-eu-priorities_e



1.7 Veprimet dhe të drejtat e Bashkimit European në lidhje me: barazinë gjinore, ndryshimet klimatike, diskriminimin

Bashkimi European i kushton një rëndësi të madhe ruajtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore. Ekzistojnë disa mekanizma dhe institucione të cilët punojnë për të garantuar respektimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut brenda vendeve që janë anëtare të komunitetit european.

Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe përfundimet e Komitetit të Kartës Sociale Europiane pohojnë ndërlidhjet e pamohueshme midis mbrojtjes së mjedisit dhe të drejtave të njeriut. Në këtë kapitull do të përballemi me politikat e vënë në veprim nga Bashkimi European për mbrojtjen e të drejtave që lidhen me barazinë gjinore, ndryshimet klimatike dhe diskriminimin.

Barazia Gjinore

Barazia gjinore përbën një vlerë thelbësore dhe qendrore brenda Bashkimit European (BE). BE-ja është e përkushtuar për të promovuar dhe garantuar barazinë gjinore në të gjitha shtetet e saj anëtare. Gjatë viteve, nisma, politika dhe strategji të ndryshme janë prezantuar për të trajtuar pabarazitë gjinore dhe për të promovuar mundësi të barabarta midis grave dhe burrave. Së fundmi, Bashkimi European ka zhvilluar një plan strategjik që synon mbrojtjen e barazisë gjinore. Kjo strategji përcakton synime dhe veprime specifike për të bërë progres të rëndësishëm drejt arritjes së barazisë gjinore. Fushat kryesore të fokusit përfshijnë eliminimin e dhunës me bazë gjinore, sfidimin e stereotipeve, zvogëlimin e pabarazive gjinore në tregun e punës, arritjen e pjesëmarrjes së drejtë në sektorë të ndryshëm, adresimin e boshllëqeve të pagave dhe pensioneve, reduktimin e pabarazive në përgjegjësitë e kujdesit dhe promovimin e ekuilibrit gjinor në vendimmarrje dhe politika^[5].

[5] Gender equality strategy.

https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en

Ndryshimet klimatike

Bashkimi European (BE) është i përkushtuar për zbatimin e një politike gjithëpërfshirëse mbi ndryshimet klimatike që synon zbutjen e emetimeve të gazeve serrë, promovimin e praktikave të qëndrueshme dhe arritjen e neutralitetit klimatik. Marrëveshja e Gjelbër për Europën është nisma thelbësore që përshkruan udhërrëfyesin e BE-së drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe neutrale ndaj klimës. Marrëveshja mbulon sektorë të ndryshëm dhe synon të transformojë BE-në në kontinentin e parë në botë që arrin neutralitetin klimatik deri në vitin 2050[6].

Diskriminimi

Në kuadër të zbatimit të Traktatit për themelimin e Komunitetit European dhe Traktatit të Bashkimit European, çdo diskriminim në bazë të kombësisë është i ndaluar[7]. Çdo formë diskriminimi është i ndaluar, bazuar në çfarëdo baze si gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, origjina etnike ose sociale, veçoritë gjenetike, gjuha, feja ose besimet, opinioni politik ose çdo status tjetër, anëtarësia në një pakicë kombëtare, pasuria, lindja, aftësitë e kufizuara, mosha ose orientimi seksual. Kjo e drejtë është e sanksionuar në nenin 21 të Kartës së të Drejtave Themelore[8].

[6] Climate change: what the EU is doing:
<https://www.consilium.europa.eu/en/policies/climate-change>

[7] Non-discrimination
https://commission.europa.eu/aid-development-cooperation-fundamental-rights/your-rights-eu/know-your-right/equality/non-discrimination_enon-discrimination

[8] EU Charter of Fundamental Rights
<https://fra.europa.eu/en/eu-charter/article/21-non-discrimination#:~:text=1,sexual%20orientation%20shall%20be%20prohibited.>

Kapitulli 2

Të jetosh në Bashkimin European



2.1 Të jetosh në BE

Shtetësia europiane është plotësuese e shtetësisë kombëtare. Kjo do të thotë që çdo qytetar i një shteti anëtar i Bashkimit European është automatikisht edhe qytetar europian. Shtetësia europiane përfshin si të drejta ashtu edhe përgjegjësi. [Neni 18 i Traktatit për Funkcionet e Bashkimit European \(TFEU\)](#) dhe [Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European](#) garantojnë të drejtat e qytetarëve europianë. Këto të drejta sigurohen nga Komisioni European, i cili është përgjegjës për zbatimin dhe respektimin e ligjit të BE-së, veçanërisht në lidhje me aspektet kyçe të jetës së përditshme si e drejta për kujdes shëndetësor, e drejta e qëndrimit dhe të drejtat që lidhen me familjen ose marrëdhëniet. Me rëndësi është se qytetarët europianë kanë të drejtë të jetojnë dhe të lëvizin brenda Bashkimit European pa diskrimimuar bazuar në kombësinë e tyre.

2.2 Të udhëtosh në BE

Qytetarët europianë kanë lirinë e lëvizjes së lirë brenda zonës Shengen, e krijuar në 1985, e cila përfshin 27 vende. Zona Shengen është një zonë e lëvizjes së lirë pa kontrolle të kufijve të brendshëm. Nëse i përkisni një prej vendeve të Shengenit, ju gjithashtu keni mundësinë të lëvizni lirshëm në vendet e tjera të Shengenit pa iu nënshtruar kontrolleve kufitare. Si qytetar europian, ju gjithashtu keni akses në të drejtat e pasagjerëve në nivel europian për udhëtimet tuaja duke fluturuar, përmes rrugëve të komunikimit të brendshëm (me makina ose trena) dhe duke përdorur rrugët detare. Këto të drejta përfshijnë rregullore specifike për të siguruar mbrojtjen tuaj, megjithëse nuk kërkohet pasaportë për të kaluar kufijtë brenda hapësirës europiane. Është thelbësore të keni një dokument udhëtimi të vlefshëm, si pasaportë ose kartë identiteti kombëtare kur udhëtoni brenda Bashkimit Europian. Kjo mund të kërkohet për arsye identifikimi ose sigurie gjatë udhëtimeve tuaja brenda, në dhe nga BE. **Për shtetasit të cilët nuk janë qytetar të BE-së, duhet një dokument qëndrimi afatshkurtër, dhe ata duhet të kenë dy dokumente për të udhëtuar në Europë: pasaportën dhe ose një vizë. Ndiqni linqet e mëposhtme për më shumë informacion mbi të drejtat tuaja gjatë udhëtimeve në BE.**

https://europa.eu/youreurope/citizens/travel/entry-exit/index_en.htm

2.3 Të punosh në Bashkimin European

Si qytetar european, ju keni të drejtë të punoni në çdo vend të Bashkimit European pa pasur nevojë për leje pune. Për më tepër, ju keni të drejtë të banoni në vendin pritës, në varësi të kushteve të caktuara. Nëse vendosni të jetoni dhe punoni në një vend të BE-së të ndryshëm nga vendi juaj, është thelbësore të jeni të informuar për të drejtat tuaja të punës dhe detyrimet tatimore, të cilat garantoohen dhe rregullohen nga legjislacioni kombëtar.

Për më tepër, BE-ja ofron mundësi dhe mbështetje shtesë për punësim dhe trajnim profesional. Për të lehtësuar kërkimin e punës për qytetarët europianë në një botë gjithnjë e më të globalizuar dhe të ndërlidhur, BE-ja ka krijuar EURES (Shërbimet Europiane të Punësimit), një rrjet që ofron informacione dhe shërbime këshillimore falas për të lehtësuar lëvizshmërinë profesionale Europiane.

2.4 Emigracioni në BE

Bashkimi European dhe shtetet e tij anëtare ndajnë kompetenca në fushën e emigracionit, por vendimi përfundimtar për kërkesat e emigracionit është në dorën e secilit prej vendeve anëtare. Në zonat ku nuk ka rregullore europiane, shtetet anëtare kanë autoritetin të vendosin kushte për marrjen e lejeve të qëndrimit dhe punës në vendet e tyre. Këshilli European luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim duke përcaktuar prioritetet strategjike.

Për të aplikuar për vizë ose leje qëndrimi, duhet të kontaktoni gjithmonë autoritetet e shtetit anëtar ku dëshironi të lëvizni. Nuk ka asnjë institucion të BE-së që menaxhon apo lëshon viza dhe leje qëndrimi në emër të vendeve të veçanta.

Për politikat e migracionit, veçanërisht për individët më vulnerabël si refugjatët politikë dhe azilkërkuesit, BE-ja ka krijuar një Sistem të Përbashkët European të Azilit (CEAS), i cili vendos standardet minimale për trajtimin e të gjithë azilkërkuesve dhe aplikimeve për azil në BE.

2.5 Studimet, trajnimet dhe vullnetarizmi në Bashkimin European

Bashkimi European mbështet përpjekjet e bëra nga shtetet anëtare për të ofruar një standard të lartë arsimimi dhe trajnimi për qytetarët e tyre. BE promovon në mënyrë aktive shumëgjuhësinë në Europë, duke mbështetur mësimdhënien dhe mësimin e gjuhëve. Kjo bën që studentët, të trajnuarit, vullnetarët, mësuesit dhe të rinjtë, të ndjehen të inkurajuar të lëvizin në rajon si dhe të shkëmbejnë informacionit dhe përvoja përmes programeve specifike të financuara nga BE. Programet Erasmus+ për Lëvizshmërinë e Studentëve ose Praktikat e Punës ofrojnë fonde, mjete dhe burime për studentët që dëshirojnë të studiojnë jashtë vendit. Për praktikën e punës, BE-ja u ofron të rinjve mundësinë për të fituar aftësi të reja profesionale përmes punësimit, duke ofruar përvojë të vlefshme për ata që hyjnë në fuqinë punëtore. Për sa i përket vullnetarizmit, është krijuar një portal european, i cili u mundëson të rinjve të përfshihen në përvojat vullnetare europiane.

Kapitulli 3

Qytetaria në Bashkimin European

3.1 Zgjedhjet Europiane dhe e drejta e votës

Qytetarët e Bashkimit European kanë të drejtë të votojnë dhe të kenë të drejtë zgjedhjeje për zgjedhjet e Parlamentit European, në shtetin anëtar ku ata banojnë, në të njëjtat kushte si qytetarët e atij vendi. Anëtarët e Parlamentit European zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë universal, duke përdorur një proces votimi të lirë dhe të fshehtë

Nëpërmjet zgjedhjeve Europiane, qytetarët e Bashkimit European zgjedhin përfaqësuesit e tyre si deputetë të Parlamentit European. Parlamenti European është e vetmja asamble ndërkombëtare e zgjedhur drejtpërdrejt në botë. Anëtarët e Parlamentit European shërbejnë si avokatë për interesat e qytetarëve të BE-së në nivel europian. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e qeverive të vendeve të BE-së, ata janë përgjegjës për zhvillimin dhe miratimin e dispozitave të reja që rregullojnë jetën e qytetarëve të BE-së në sektorë të ndryshëm.

Këto përfshijnë mbështetjen për ekonominë, luftën ndaj varfërisë, mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e vlerave themelore të Bashkimit European, si respektimi i të drejtave të njeriut, liria, demokracia, barazia dhe sundimi i ligjit.



3.2 Iniciativa e Qytetarëve Europeanë

Iniciativat e ndërmarra nga qytetarët europianë ofrojnë një mjet për të marrë pjesë në jetën publike të BE-së duke i kërkuar Komisionit European të propozojë ligje të reja. Megjithatë, këto nisma duhet të mbledhin 1 milion nënshkrime për t'u pranuar nga organi ekzekutiv i BE-së. Nismat e qytetarëve përfaqësojnë një mjet të rëndësishëm për demokracinë pjesëmarrëse në dispozicion të qytetarëve europianë, duke u ofruar atyre përfshirje më të madhe në formësimin e politikave të BE-së që ndikojnë në jetën e tyre. Kjo ofron një mundësi për qytetarët në mbarë Bashkimin European që të mobilizohen për çështje me interes të përbashkët, të nxisin debatin dhe të ndërmarrin reforma duke propozuar ndryshime konkrete legjislative.

3.3 Peticion për Parlamentin European

Çdo shtetas i Bashkimit European ose rezident në një shtet anëtar ka të drejtë të bëjë petition në Parlamentin European, individualisht ose në bashkëpunim me qytetarë të tjerë, për një çështje që shqetëson drejtpërdrejt Bashkimin European. Kjo e drejtë për petition garantohet nga Traktati i Mاستrihtit. Një petition mund të formulohet si ankesë ose kërkesë dhe mund të trajtojë çështje me interes publik ose privat. Peticioni mund të përfshijë një kërkesë personale, një ankesë ose një vërejtje në lidhje me zbatimin e legjislacionit të BE-së, ose mund të ftojë Parlamentin European të marrë një qëndrim për një çështje specifike.

Këto peticione i ofrojnë Parlamentit European mundësinë për t'i tërhequr vëmendjen për çdo shkelje të të drejtave të qytetarëve europianë një shteti anëtar, autoriteteve lokale ose një institucioni.

3.4 Këshilltarët Vendorë

Këshilltarët vendorë kanë njohuritë, përvojën dhe kontaktet që i bëjnë ata ndërmjetës të shkëlqyeshëm për çështjet që lidhen me BE-në në bashkitë e tyre, duke zvogëluar hendekun midis strukturave europiane dhe atyre vendore. Kjo është projektuar për të lehtësuar bashkëpunimin midis këshilltarëve vendorë, duke promovuar debate për të ofruar akses më të madh në një sërë shërbimesh, webinarë dhe materiale të përditësuara për t'u thelluar në tema të lidhura me BE-në. Qëllimi përfundimtar është të mbështesë formimin e një opinioni të përbashkët publik europian. Përfaqësuesit vendorë luajnë një rol strategjik në këtë iniciativë të paprecedentë, duke përfshirë komunitetet në çështjet që kanë të bëjnë me BE-në. Ata janë përfaqësuesit institucionalë më të afërt me territorin, që ndajnë të njëjtën gjuhë dhe prejardhje me njerëzit që jetojnë në zonë, ndonjëherë duke u ndjerë të marginalizuar. Këshilltarët që marrin pjesë në rrjetin BELC janë elementë thelbësorë të një qeverisjeje europiane që përfshin institucionet, komunitetet lokale dhe qytetarët, të cilët shprehin votat e tyre në zgjedhjet europiane **të vitit 2024**.

Aktivitetet

Aktiviteti 1

Simulimi i Parlamentit European



Tema	Shtetësia e BE-së; demokracia pjesëmarrëse; të drejtat dhe vlerat;
Titulli	Simulimi i Parlamentit të BE-së
Qëllimet	Ndërgjegjësimi për vlerat dhe parimet themelore të BE-së; Veprimet e BE-së për të garantuar dhe mbështetur të drejtat; për të rritur ndjenjën e qytetarisë europiane të pjesëmarrësve duke iu referuar jetës dhe nevojave të tyre
Kohëzgjatja	<ul style="list-style-type: none">• Hapi 1: 25 minuta;• Hapi 2: 25 minuta;• Hapi 3: 10 minuta;• Hapi 4: 15 minuta;• Gjithsej 90 minuta
Mjetet	"Tavolina, karrige, lapsa, letër, flipcharts"
Pjesëmarrësit	Të paktën 10 pjesëmarrës, të ndarë në grupe të ndryshme

Përshkrimi

Hapi 1

Trajneri i ndan pjesëmarrësit në disa grupe. Secili grup identifikohet me një vend europian, ose ata mund të zgjedhin një emër krijues, duke e nxjerrë atë nga një listë shtetesh ose emrash të përcaktuar më parë nga trajneri. Grupet fillojnë sesionin e parë veçmas nga njëri-tjetri, duke identifikuar një temë midis barazisë gjinore, diskriminimit, ndryshimeve klimatike. Në fazën e parë, duke u nisur nga konteksti i tyre lokal, secili grup identifikon nevojat e tij për këto çështje. Ata më pas zhvillojnë një sërë veprimesh politike për të gjetur një zgjidhje.

Hapi 2

Grupet do të kthehen në punë plenare, duke paraqitur punën e kryer përmes hapave të mëposhtëm: 1) cili është problemi që ata kanë identifikuar; 2) çfarë propozimesh kanë menduar për ta zgjidhur atë.

Hapi 3

Pasi grupet paraqesin propozimet e tyre, secili person voton për propozimet e grupeve të tjera. Grupi me numrin më të madh të votave fiton zgjedhjet. Për të krijuar më shumë suspansë, trajneri që mbledh votat do të shpallë vetëm fituesin në fund.

Hapi 4

Pas votimit, është e rëndësishme që trajneri të udhëheqë një diskutim të përgjithshëm mbi punën e kryer nga grupet, i fokusuar në temat, pikat e forta dhe të dobëta të propozimeve të grupeve.

Aktiviteti 2

Simulimi i Parlamentit European



Tema	Historia e BE-së, institucionet, rolet, vlerat dhe parimet e tij
Titulli	Kuiz mbi BE
Qëllimet	Të prezantojë Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit European dhe t'u mundësojë pjesëmarrësve të shprehin mendimet dhe përvojat e tyre në lidhje me çështjet e mbuluara nga Karta.
Kohëzgjatja	90 deri në 120 minuta
Mjetet	Kompjuter, projektor
Pjesëmarrësit	Individual

Përshkrimi

Pjesëmarrësit duhet të lexojnë Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit European përpara sesionit dhe të mendojnë për shembuj të shkeljes së të drejtave individuale, qytetare, politike, ekonomike dhe sociale të parashikuara në të.

Hapi 1

Trajnerët fillojnë me një hyrje mbi Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, duke shpjeguar rëndësinë dhe zbatimin e saj.

Hapi 2

Trajnerët lexojnë nenet e Kartës dhe pjesëmarrësit komentojnë duke ndarë përvojën e tyre mbi mbrojtjen dhe shkeljet e të drejtave themelore në nivel lokal, kombëtar ose Europian. Pas kësaj, trajnerët do të zhvillojnë një përmbledhje.

Pjesëmarrësve u kërkohet të reflektojnë mbi to përmes pyetjeve:

- Për cilat të drejta themelore nuk kishit dijeni përpara se të lexonit Kartën? Si e plotësuan përvojat e të tjerëve të mësuarit tuaj për të drejtat themelore?

Pyetëtori përfundimtar i vetëvlerësimit. Le të vlerësojmë njohuritë tuaja për Bashkimin Europian.

- Ju lutemi, plotësoni këtë pyetësor të vetëvlerësimit. Mundohuni të krahasoni rezultatin me pyetësin e parë në fillim të modulit:

https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSeshA5TgG_0i8S_eeikjNAVv0_1q6I3cbPLRz9W3FIJlvz5Sw/viewform

Referenca

Neni 2 Traktati i Bashkimit Europian:

<https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/146/the-protection-of-article-2-teu-values-in-the-eu>

and

https://eur-lex.europa.eu/eli/treaty/teu_2012/art_2/oj

Karta e të Drejtave Themelore të BE-së

https://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

Prioritetet e Bashkimit Europian 2019-2024

https://european-union.europa.eu/priorities-and-actions/eu-priorities/how-eu-priorities-are-set/infographic-eu-priorities_en

Strategjia mbi Barazine Gjimore e Bashkimit Europian

https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-equality-strategy_en

BE për ndryshimet klimatike: çfarë po bën BE:

<https://www.consilium.europa.eu/en/policies/climate-change/>

BE për mosdiskriminimin

https://commission.europa.eu/aid-development-cooperation-fundamental-rights/your-rights-eu/know-your-right/equality/non-discrimination_en

Partnerët



Coordinator
FEMMES ENTRAIDE ET AUTONOMIE / France
www.feaasso.org



CESIE / Italy
cesie.org



People in Focus / Albania
www.peopleinfoocus.org



SAVE A GIRL SAVE A GENERATION / Spain
www.saveagirlsaveageneration.org

Impressum


Ky botim është zhvilluar dhe publikuar në kuadër të projektit "Pivot. Të rinjtë promovojnë votën e informuar" (2023-1-FR02-KA220-YOU-000167160)

Koordinatori i Projektit: Femmes Entraide et Autonomie.

Partnerët e projektit: CESIE, People in Focus, Save a Girl Save a Generation

Dizajni: CESIE.

Botuar në qershor 2024. Financuar nga Bashkimi Europian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë megjithatë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Europian.



PiVot



KA220-YOU – Cooperation partnerships in youth

Financuar nga Bashkimi Europian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Europian dhe apo të "Agence du Service Civique- Agence Erasmus+ France Jeunesse & Sport". As Bashkimi Europian dhe as "Agence du Service Civique- Agence Erasmus+ France Jeunesse & Sport " nuk janë përgjegjës për ato.

Numri i projektit : 2023-1-FR02-KA220-YOU-000167160



**Co-funded by
the European Union**